



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:196662
Datë: 08.01.2025
Numri i dokumentit: 06687540

C.nr.1645/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Nazmi Neziri, në çështjen juridike-civile të paditësit M. S. nga P., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokatura “K. & A.”, me avokatët e saj nga P., B..D. e K., U. C-..., ..., kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit nga Podujeva, Rruga “N. G.” pn., baza e kontestit: për shkak të kompensimit material në emër të shtesës për kualifikim, vlera e kontestit: e pa përcaktuar, jashtë seancës me datë 06.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET se është tërhequr padia e paditësit M. S. nga P., kundër të paditurit Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit nga Podujeva, Rruga “N. G.” pn., lidhur me çështjen për kompensim material në emër të shtesës për kualifikim

A r s y e t i m

Paditësi M. S. nga P., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokatura “K. & A.”, me avokatët e saj nga P., B..D. e K., U. C-..., ..., me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.1645/2024 të dt.03.12.2024, është ftuar që ta bëjë rregullimin e padisë në aspektin objektiv dhe atë: të bëjë rregullimin e petitumit të padisë duke e përcaktuar qartë kërkesëpadinë me të cilën do të saktësojë shumën e kërkuar për secilën kërkesë, Të përcaktojë vlerën e kontestit, Të përcaktoj periudhën brenda të cilës kërkon kompensimin, Ti dorëzojë provat e cekura në padi për vërtetimin e fakteve.

Nga shkresat e lëndës shihet se të njëjtin aktvendim paditësi-i autorizuari i tyre e ka pranuar më dt.19.12.2024, siç vërtetohet nga fletë kthesa në shkresat e lëndës.

Bazuar si më lartë pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata konstatoi se për objektin e kontestit nuk ekziston më interes juridik, pasi që paditësi në afatin e caktuar nga gjykata (dhe deri në momentin e nxjerrjes së këtij aktvendimi), nuk e ka paraqitur padinë e përmirësuar-plotësuar në aspektin objektiv siç është kërkuar me aktvendimin e cituar, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të dispozitave të nenit 102.3 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), e konsideroi të tërhequr padinë.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, Departamenti i përgjithshëm

Numri i lëndës: 2024:196662
Datë: 08.01.2025
Numri i dokumentit: 06687540

C.nr.1645/2024 të datës 06.01.2025

Gjyqtari:
Nazmi Neziri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.